

**GRANT THORNTON SHPK**

Pasqyrat Financiare për periudhën e mbyllur  
me 31 Dhjetor 2013

Në monedhë lokale – LEK (ALL)

**PERMBAJTJA:**

<b>BILANCI KONTABEL</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL</b>	<b>6</b>
1. Informacion i pergjithshem	7
2. Bazat e pregatitjes se pasqyrave financiare	7
3. Politikat kontabel	10
4. Aktivitet monetare	11
5. Aktive financiare afatshkurtra	11
6. Te tjera aktive afatshkurtra	11
7. Aktivitet afatgjata	12
7. Aktivitet afatgjata (vazhdim)	13
8. Furnitore dhe te tjera detyrime afatshkurtra	14
9. Detyrime tatimore	14
10. Kapitali aksioner	14
11. Te ardhurat	15
12. Kosto e punes	15
13. Shpenzime te tjera	16
14. Fitime / (humbje) nga kurset e kembimit	16
15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17
16. Angazhimet, detyrimet dhe te drejtat e kushtezuara	18
17. Transaksionet me palet e lidhura	18
18. Ngjarje pas dates se raportimit	19


**BILANCI KONTABEL**  
 me 31 Dhjetor 2013

AKTIVET	Shënime	Në 31 Dhjetor	
		2013 LEK	2012 LEK
Aktive monetare	4	1,407,765	397,565
Aktive financiare afatshkurtra	5	7,988,203	7,445,760
Të tjera aktive afatshkurtra	6	1,073,048	676,412
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>10,469,016</b>	<b>8,519,737</b>
Aktive afatgjata materiale, neto	7	1,966,344	2,308,879
Aktive afatgjata jomateriale, neto	7	55,225	73,633
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>2,021,569</b>	<b>2,382,512</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>12,490,585</b>	<b>10,902,249</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
Furnitorë dhe të tjera detyrime afatshkurtra	8	8,083,489	8,328,313
Detyrime tatimore	9	528,970	290,497
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>8,612,459</b>	<b>8,618,810</b>
Kapital aksionar	10	1,908,100	1,908,100
Rezerva për investime		374,512	261,148
Fitimi i pashpërndarë		1,595,514	114,191
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>3,878,126</b>	<b>2,283,439</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>12,490,585</b>	<b>10,902,249</b>

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese ne faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 3 deri 19 janë firmosur dhe aprovuar me 21 Mars 2014 nga:

Hartuesi

Behar Barjamaj  
Financier



Aprovuar

Jonida Muka  
Administrator


**PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**  
për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Shënime	Për vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2013 LEK	2012 LEK
<b>Të ardhurat</b>			
Të ardhurat nga shitja e shërbimeve		37,891,959	36,716,950
		<hr/>	<hr/>
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>11</b>	<b><u>37,891,959</u></b>	<b><u>36,716,950</u></b>
<b>Shpenzime operative</b>			
Kosto e punës	12	29,161,189	28,099,738
Amortizimet dhe zhvlerësimet	7	499,193	444,076
Shpenzime të tjera	13	6,352,958	7,743,892
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b><u>36,013,340</u></b>	<b><u>36,287,706</u></b>
<b>Fitimi / (humbja) nga veprimtaritë kryesore</b>		<b><u>1,878,619</u></b>	<b><u>429,244</u></b>
Fitimet / (humbjet) nga kursi i këmbimit	14	(50,947)	(166,674)
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b><u>1,827,672</u></b>	<b><u>262,570</u></b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	232,985	149,206
<b>Fitimi / (humbja) neto e vitit financiar</b>		<b><u>1,594,687</u></b>	<b><u>113,364</u></b>

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE**  
 për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Shënime	Për vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2013 LEK	2012 LEK
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
Fitimi (humbja) para tatimit		1,827,672	262,570
Rregullime për:			
Amortizime dhe zhvlerësime	7	499,193	444,076
<b>Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit para rregullimeve në kapitalin punues</b>		<b>2,326,865</b>	<b>706,646</b>
(Rritje) zvogëlim në tepricën e kërkesave të arkëtueshme dhe aktiveve të tjera		(939,079)	(4,534,949)
Rritje (zvogëlim) në tepricën e detyrimeve për t'u paguar nga aktiviteti dhe detyrimeve të tjera		(75,336)	5,023,049
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>1,312,450</b>	<b>1,194,746</b>
Tatim mbi fitimin i paguar		(164,000)	(326,530)
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>		<b>1,148,450</b>	<b>868,216</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(138,250)	(566,048)
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e investimit</b>		<b>(138,250)</b>	<b>(566,048)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e financimit</b>			
Te ardhura nga arkëtimi i kapitalit aksionar		-	-
Disbursime nga huamarrje		-	-
Pagesa të huamarrjeve		-	-
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtaritë e financimit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i mjeteve monetare</b>		<b>1,010,200</b>	<b>302,168</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	4	397,565	95,397
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>4</b>	<b>1,407,765</b>	<b>397,565</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**  
 për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Kapitali aksionar LEK	Rezerva për investime LEK	Fitimi i pashpërndarë LEK	Totali LEK
<b>Pozicioni në 1 Janar 2012</b>	1,908,100	-	261,975	2,170,075
Kapital aksionar	-	-	-	-
Transferimet e fitimeve te pashpërndara	-	261,148	(261,148)	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	113,364	113,364
<b>Pozicioni ne 31 Dhjetor 2012</b>	<b>1,908,100</b>	<b>261,148</b>	<b>114,191</b>	<b>2,283,439</b>
<b>Pozicioni ne 1 Janar 2013</b>	1,908,100	261,148	114,191	2,283,439
Kapital aksionar	-	-	-	-
Transferimet e fitimeve te pashpërndara	-	113,364	(113,364)	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	1,594,687	1,594,687
<b>Pozicioni në 31 Dhjetor 2013</b>	<b>1,908,100</b>	<b>374,512</b>	<b>1,595,514</b>	<b>3,878,126</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 7 – 19 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria Grant Thornton është shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar me 23.07.2009 në përputhje me Ligjin “Për Shoqëritë Tregtare”.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e shërbimeve të auditimit, konsulence për taksat dhe shërbime kontabiliteti.

Administratore e shoqërisë është Znj. Jonida Muka. Me 31 Dhjetor 2013 shoqëria kishte 15 punonjës (31 Dhjetor 2012: 16 punonjës).

Selia qendrore e shoqërisë është në adresën: Rr “Sami Frasheri”, Kompleksi T.I.D, Shk. B, Kati 1, Tirane. Ajo është regjistruar si person i tatueshëm në rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatueshëm K91923007M.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013 janë aprovuar nga administratori me 21 Mars 2014.

## 2. BAZAT E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

### a. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë të shprehura në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

### b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### c. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

#### *(i) Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

*(ii)Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitet afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitet. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale bazuar ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat” (i ndryshuar) si më poshtë:

<b>Kategoria</b>	<b>Metoda e amortizimit</b>	<b>Norma e amortizimit</b>
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje dhe programe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivitet afatgjata jomateriale njihen atëherë kur është e mundur qe përfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne mënyrë të besueshme.



**d. Llogarite e arkëtueshme dhe llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**e. Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

**f. Transaksione në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2013</u>	<u>31 Dhjetor 2012</u>
1 EUR	140.20	139.59

**g. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

**h. Tatim fitimi**

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2013. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 10% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2013 (2012: 10%)

**i. Biznesi ne vijimësi**

Te dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qenë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të veçantë me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimësi.

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

**3. POLITIKAT KONTABEL**

Politikat kontabël janë organizuar bazuar në ligjin për “Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

**4. AKTIVET MONETARE**

Aktivitet monetare përbëhen nga Paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe janë analizuar si më poshtë:

	2013 LEK	2012 LEK
<b>Arka</b>	<b>86</b>	<b>1,917</b>
- në Lek	86	1,917
- në monedhë të huaj	-	-
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>1,407,679</b>	<b>395,648</b>
- në Lek	994,602	53,202
- në monedhë të huaj	413,077	342,446
	<u>1,407,765</u>	<u>397,565</u>

**5. AKTIVE FINANCIARE AFATSHKURTRA**

Aktivitet financiare afatshkurtra përbëhen nga klientët të cilët janë detajuar si më poshtë:

	2013 LEK	2012 LEK
Klientë vendas	151,248	2,908,387
Klientë të huaj	2,163,762	150,757
Palë te lidhura	5,673,193	4,386,616
	<u>7,988,203</u>	<u>7,445,760</u>

**6. TE TJERA AKTIVE AFATSHKURTRA**

Të tjera aktive financiare përbëhen nga garanci të dhëna të tretëve, qera e parapaguar, shpenzimet të tjera të parapaguara dhe të tjera të drejta për tu arkëtuar.

	2013 LEK	2012 LEK
Garanci dhënë të tretëve	575,800	573,360
Qera e parapaguar	-	-
Abonim i parapaguar dhe anëtarësime	91,512	91,518
Të tjera	405,736	11,534
	<u>1,073,048</u>	<u>676,412</u>

**Grant Thornton Sh.p.k****Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare****Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013****7. AKTIVET AFATGJATA**

Aktivet afatgjata janë analizuar si më poshtë:

<b>Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013</b>	<b>Mobilje dhe paisje zyre LEK</b>	<b>Paisje informatike LEK</b>	<b>Mjete transporti LEK</b>	<b>Paisje të tjera LEK</b>	<b>Programe LEK</b>	<b>Totali LEK</b>
<b>Aktivet me kosto</b>						
Gjendja me 1 Janar	1,894,391	497,484	863,003	107,408	149,603	3,511,889
Shtesat	10,280	127,970	-	-	-	138,250
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<b>1,904,671</b>	<b>625,454</b>	<b>863,003</b>	<b>107,408</b>	<b>149,603</b>	<b>3,650,139</b>
<b>Amortizimi</b>						
Gjendja me 1 Janar	682,089	252,716	71,917	46,686	75,969	1,129,377
Shtesat	244,174	66,249	158,218	12,144	18,408	499,193
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<b>926,263</b>	<b>318,965</b>	<b>230,135</b>	<b>58,830</b>	<b>94,377</b>	<b>1,628,570</b>
<b>Vlera e mbetur me 01 Janar</b>	<b>1,212,302</b>	<b>244,768</b>	<b>791,086</b>	<b>60,722</b>	<b>73,634</b>	<b>2,382,512</b>
<b>Vlera e mbetur me 31 Dhjetor</b>	<b>978,408</b>	<b>306,489</b>	<b>632,868</b>	<b>48,578</b>	<b>55,226</b>	<b>2,021,569</b>

Grant Thornton Sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

7. AKTIVET AFATGJATA (VAZHDIM)

Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2012	Mobilje dhe pajsje zyre LEK	Pajsje informatike LEK	Mjete transporti LEK	Pajsje të tjera LEK	Programe LEK	Totali LEK
<b>Aktivët me kosto</b>						
Gjendja me 1 Janar	1,507,355	497,484	-	107,408	149,603	2,261,850
Shtesat	387,036	-	863,003	-	-	1,250,039
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<b>1,894,391</b>	<b>497,484</b>	<b>863,003</b>	<b>107,408</b>	<b>149,603</b>	<b>3,511,889</b>
<b>Amortizimi</b>						
Gjendja me 1 Janar	431,243	171,127	-	31,506	51,425	685,301
Shtesat	250,846	81,589	71,917	15,180	24,544	444,076
Pakësimet	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor	<b>682,089</b>	<b>252,716</b>	<b>71,917</b>	<b>46,686</b>	<b>75,969</b>	<b>1,129,377</b>
Vlera e mbetur me 01 Janar	1,076,112	326,357	-	75,902	98,178	1,576,549
Vlera e mbetur me 31 Dhjetor	<b>1,212,302</b>	<b>244,768</b>	<b>791,086</b>	<b>60,722</b>	<b>73,634</b>	<b>2,382,512</b>

**8. FURNITORE DHE TE TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA**

Të pagueshmet ndaj furnitorëve dhe të tjera detyrime afatshkurtra janë analizuar si më poshtë.

	2013 LEK	2012 LEK
Furnitorë vendas	668,122	1,160,383
Detyrime ndaj personelit	1,483,792	1,926,577
Shpenzime të llogaritura	136,419	195,962
Palë të lidhura	5,431,348	4,709,767
Qera për tu paguar	239,742	238,699
Të tjera	124,066	96,925
	<u>8,083,489</u>	<u>8,328,313</u>

**9. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore janë analizuar si më poshtë.

	2013 LEK	2012 LEK
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	320,826	316,687
Tatimi mbi të ardhurat personale	205,110	186,725
TVSH për tu paguar	206,059	59,211
Tatim në burim	26,638	26,522
Tatim fitimi për tu paguar/(marrë)	(229,663)	(298,648)
	<u>528,970</u>	<u>290,497</u>

**10. KAPITALI AKSIONER**

Grant Thornton është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me kapital 1,908,100 Lekë. Kapitali zotërohet 51% nga shoqëria e auditimit Grant Thornton Doo, Shkup, Maqedoni dhe 49% nga shoqëria e konsulencave Grant Thornton Consulting Doo, Shkup, Maqedoni.

**Grant Thornton Sh.p.k**  
**Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare**  
**Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013**

**11. TE ARDHURAT**

Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	37,891,959	36,716,950
Të ardhura nga shitja	<u><u>37,891,959</u></u>	<u><u>36,716,950</u></u>

Rakordimi i te ardhurave me deklaratimet ne sistemin e tatimeve është si më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Të ardhura nga shitja e shërbimeve	37,891,959	36,716,950
Auto faturime	968,877	-
Të ardhura te deklaruar ne sistemin e tatimeve	<u><u>38,860,836</u></u>	<u><u>36,716,950</u></u>

**12. KOSTO E PUNES**

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	<b>2013</b>	<b>2012</b>
	<b>LEK</b>	<b>LEK</b>
Paga dhe shpërblime	26,554,352	25,926,812
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,606,837	2,172,926
	<u><u>29,161,189</u></u>	<u><u>28,099,738</u></u>

**13. SHPENZIME TE TJERA**

	2013 LEK	2012 LEK
Utilitete	299,368	159,727
Qera	3,198,441	3,120,234
Mirëmbajtje	246,522	366,295
Kuote anëtarësimi GTI	311,300	-
Konsulencë	340,983	111,039
Udhëtime dhe dieta	149,994	299,134
Shpenzime postare dhe komunikacioni	379,223	607,787
Kuota e anëtarësimit (IEKA)	164,149	246,430
Komisione bankare	117,663	220,296
Kancelari	178,320	336,076
Taksa lokale	15,120	15,120
Gjoha	39,101	319,976
Shpenzime marketingu	21,600	99,000
Sponsorizime	-	151,315
Shpenzime transporti	295,839	670,736
Argëtim i personelit	45,703	245,875
Shpenzime përkthime dhe noterizime	114,280	136,320
Abonimi në shtypin e ditës	42,591	39,502
Anëtarësim në dhomën e tregtisë	99,997	156,451
Shërbime shëndetësore për personelin	11,455	144,727
Shpenzime të tjera	281,309	297,852
	<u>6,352,958</u>	<u>7,743,892</u>

**14. FITIME / (HUMBJE) NGA KURSET E KEMBIMIT**

Fitime / (humbje) nga kurset e këmbimit janë analizuar si më poshtë:

	2013 LEK	2012 LEK
Fitime nga kurset e këmbimit	331,553	242,854
Humbje nga kurset e këmbimit	(382,500)	(409,528)
	<u>(50,947)</u>	<u>(166,674)</u>



**15. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN**

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 10% për vitin 2013 (2012: 10%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2013 Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël dhe fiskal (2012: fitim kontabël dhe fiskal) si më poshtë:

	2013 LEK	2012 LEK
<b>1 Fitimi para tatimit</b>	<b>1,827,672</b>	<b>262,570</b>
<b>2 Shpenzime te pazbritshme (te listuara më poshtë):</b>	<b>502,173</b>	<b>1,229,493</b>
Gjoha	39,101	319,976
Energji elektrike	252,553	137,365
Furnizime të ndryshme – pa faturë të rregullt	45,756	105,109
Pritje dhe përfaqësime – pa faturë të rregullt	35,093	4,330
Shpenzime postare – pa faturë të rregullt	1,730	250
Shpenzime transporti – pa faturë të rregullt	38,730	176,036
Shpenzime për marrjen e vërtetimeve nga institucionet	7,700	5,500
Argëtim i personelit	10,610	245,875
Sponsorizimet	-	151,315
Shpenzime të tjera	70,900	83,737
<b>3 Fitimi fiskal (1+2)</b>	<b>2,329,845</b>	<b>1,492,063</b>
<b>4 Humbjet e mbartura (-)</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>5 Norma e tatim fitimit</b>	<b>10%</b>	<b>10%</b>
<b>6 Shpenzime tatim fitimi</b>	<b>232,985</b>	<b>149,206</b>

## Grant Thornton Sh.p.k

### Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare Për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

#### 16. ANGAZHIMET, DETYRIMET DHE TE DREJTAT E KUSHTEZUARA

Angazhimet, detyrimet dhe te drejtat e kushtëzuara përfshijnë:

	2013 LEK	2012 LEK
<i>Detyrime te kushtëzuara</i>		
Garanci te dhëna	856,800	856,800
	<b>856,800</b>	<b>856,800</b>

Garancitë e dhëna më 31 dhjetor 2013 përfshinë garancitë e lëshuara nga Banka Societe Generale në shumën 856,800 Lekë. Garancia është lëshuar në favor të Bankës së Shqipërisë për periudhën deri më 30 qershor 2015. Këto instrumente nuk janë te kolateralizuara me asete të Shoqërisë.

#### 17. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra prej tyre mund të kontrollojë ose të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm në marrjen e vendimeve operative dhe financiare të palës tjetër.

Gjatë marrjes në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme midis palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria ka balancat e mëposhtëme me palët e lidhura:

	Të arkëtueshme LEK	Detyrime LEK	Të ardhura LEK	Kosto LEK
<b>31 Dhjetor 2013</b>				
Grant Thornton LLC	4,206,000	538,368	4,185,900	-
Grant Thornton Consulting Doo	1,467,193	4,892,980	-	311,300
	<b>5,673,193</b>	<b>5,431,348</b>	<b>4,185,900</b>	<b>311,300</b>

	Të arkëtueshme LEK	Detyrime LEK	Të ardhura LEK	Kosto LEK
<b>31 Dhjetor 2012</b>				
Grant Thornton LLC	-	536,026	-	-
Grant Thornton Consulting Doo	4,386,616	4,173,741	5,125,108	681,541
	<b>4,386,616</b>	<b>4,709,767</b>	<b>5,125,108</b>	<b>681,541</b>

## **18. NGJARJE PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet në pasqyrat financiare.